

Abstrakti

Marrëveshjet ndërkombetare cilësohen si mjete të rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet shteteve. Marrëveshjet ndërkombëtare sot paraqiten si një ndër instrumentet për përmbushjen e detyrimeve që kanë shtetet ndërmjet vete dhe gjithë ato bashkëpunime në fusha të ndryshme të zhvillimit të shtetit, zhvillimit kulturor, mjedisor, shoqëror, hapsirës së teritorit, teknologjis dhe më të rëndësishmës të drejtave të njëriut. Qëllimi kryesor i këtij punimi është të analizoj se si bëhet arritja e marrëveshjeve ndërkombëtare në bazë të aktereve dhe procedurave duke u ndalur në kuptimin, lidhjen, hyrjen në fuqi dhe mënyrën e zbatimit të tyre nga palët kontraktuese. Pavarësisht emërtimeve që marrëveshjet ndërkombëtare, ato janë të zbatueshme njëjloj nga palët nënshkruese dhe në të njëjtën kohë i detyrojnë ato që ti respektojnë të gjitha ato norma juridike që përmbajnë. Procedura e fazës për lidhjen e marrëveshjeve ndërkombëtare ilustruhet edhe në shumë shembuj të ndryshëm gjatë evoulimit të tyre, e deri tek përshtatja e legjislacionit të brendshëm të shteteve. MSA (Marrëveshja e Stabilizim Associmit) është një marrëveshje shumë e rëndësishme për shtetet e Ballkanit Përrëndimor në të cilën bëhet zbatimi i procesit të stabilizimit dhe asocimit.

MSA për shtetet e Ballkanit Përrëndimor ofron një tregtim të lirë me vëndet e BE-së dhe ndihmon në identifikimin dhe qëllime të përbashkëta ekonomike, politike, juridike dhe kjo bëhet përmes një bashkëpunimi të madh rajonal. Marrëveshja e Stabilizim Asocimit në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian u nënshkru në Strasburg, më 27.10.2015, MSA-ja u negociua në mes të tetorit 2013 dhe majit 2014, kurse në fuqi hyri më 1 prill 2016.

Flalët kyçe: marrëveshje, ndërkombëtare, akteret dhe procedurat, marrëveshja e stabilizim Asocimit